



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Seria 3: Statistikat Ekonomike

Statistikat e Tregtisë së Jashtme

Korrik 2018



Parathënie

Agjencia e statistikave të Kosovës (ASK) filloi të publikojë të dhënat për Importin e Kosovës që nga viti 2001.

Publikimi për Tregtinë e Jashtme është i bazuar në të dhënat e Shërbimit Doganor të Kosovës.

Të dhënat e para paraprake për Eksportin janë për vitin 2000 dhe 2001.

Të gjitha këto publikime kanë përmbajtur të dhënat paraprake dhe për arsye të përmirësimit të vazhdueshëm të kualitetit, të dhënat në këtë publikim ndryshojnë nga të dhënat paraprake të publikuara më parë.

Ky publikim përmban 7 tabela për Tregtinë e Jashtme të Kosovës për Korrik 2018 me disa krahasime ndaj Korrikut 2017. Këto tabela kanë të bëjnë me importin dhe eksportin sipas qarkullimit të mallrave, procedurave statistikor, seksioneve, vendeve si dhe sipas pikave kufitare.

Importet janë paraqitur sipas vendit të origjinës.

Komentet, vërejtjet, sugjerimet dhe propozimet tuaja lidhur me këtë publikim janë të mirëseardhura dhe ato të dërgohen në adresën elektronike: ekonomic@rks-gov.net

Publikimin e përgatitën:

Ilir T. Berisha - Drejtori i Departamentit
Ismajl Sahiti - Shef i divizionit
Mensure Çerkezi - Shefe sektori

Gusht, 2018

Kryeshef Ekzekutiv i ASK-së
Isa Krasniqi

Lista e shkurtesave

ASK	-	Agjencia e Statistikave të Kosovës
F.O.B	-	I lirë në bord (Free on board)
C.I.F.	-	Kosto, Sigurim, Transport (Cost, Insurance, Freight)
BE	-	Bashkimi Evropian
NK	-	Nomenklaturë e Kombinuar
KSTJ	-	Klasifikimi standard i tregtisë së jashtme
DUD	-	Dokument Unik Doganor
SH	-	Sistemi Harmonizuar
SNO	-	Standardet Ndërkombëtare të Organizimit
CEFTA	-	Marrëveshja e Tregtisë së Lirë me Shtetet e Evropës Juglindore
EFTA	-	Shoqata Evropiane për Tregtinë e Lirë
s.d.t	-	Specifikuara diku tjetër
s.s	-	suspension sistem (sistem i pezulluar)
d.s	-	drawback sistem (sistemi me kthim)

Simbolet

:	-	Nuk ka të dhëna
0	-	Më pak se gjysma e njësisë së përdorur
—	-	Nuk aplikohet

Përmbajtja

	Faqe
Statistikat e tregtisë së jashtme – shënime metodologjike	5
Tabela 1: Qarkullimi i mallrave në tregtinë e jashtme	9
Tabela 2: Qarkullimi i mallrave në tregtinë e jashtme, kumulativ.....	10
Tabela 3: Eksportet dhe importet sipas procedurave statistikore.....	11
Tabela 4: Eksportet dhe importet sipas seksioneve të KSTJ (SITC).....	11
Tabela 5: Eksportet dhe importet sipas seksioneve në vlerë dhe në përqindje	12
Tabela 6: Eksportet sipas vendeve në vlerë dhe në përqindje.....	13
Tabela 7: Importet sipas vendeve në vlerë dhe në përqindje.....	14

Statistikat e tregtisë së jashtme – shënime metodologjike

Burimet

Statistikat e tregtisë përbëhen kryesisht nga dokumentacioni i dorëzuar tek autoriteti doganor nga importuesit apo eksportuesit (ose agjentet e tyre). Ky dokument është Dokument Unik Doganor (DUD), i cili përdoret për qëllime të zhdoganimit. Informatat nga dokumenti barten në sistemi informativ doganor.

Përgjegjësitë për mbledhjen, përpilimin dhe publikimin e të dhënave

Administrata doganore është përgjegjëse për mbledhjen, futjen dhe përpunimin e të dhënave të deklaratës doganore. Të dhënat në fushën e statistikave që regjistrohen në DUD, raportohen në baza mujore nga Administrata Doganore, në ASK, në mënyrë elektronike.

ASK-së është përgjegjës për përpunimin dhe publikimin e të dhënave të tregtisë së jashtme. Këto statistika përfshijnë të dhënat sipas llojit të procedurave doganore. Puna shtesë përfshinë korrigjimin dhe miratimin e të dhënave doganore.

Përfshirja

Statistikat e tregtisë së jashtme nuk përfshijnë importet dhe eksportet e mallrave të përkohshme, të cilat në gjendje të pandryshuar do të kthehen pas një kohe të caktuar, siç janë shërbimet, riparimet, parat në kuptimin e rrogave, paraja në ari, furnizimi i veturave kosovare jashtë vendit me derivate, importi i mallrave për zyrat ndërlidhëse dhe misioneve tjera diplomatike në Kosovë, bagazhi personal i udhëtarëve, mostrat komerciale dhe pakot postare me vlerë të ulët.

Sistemi i regjistrimit

Statistikat e tregtisë së jashtme janë të përpiluara sipas sistemit “të veçantë” (definicioni lehtësues) të regjistrimit të tregtisë ndërkombëtare. Sipas këtij sistemi importet dhe eksportet janë të regjistruara, në kohën kur mallrat lëvizin nëpër territor me qarkullim të lirë, e kjo është, pjesa brenda ku mallrat mund të shiten pa kufizime doganore. Definicioni lehtësues nënkupton që përveç transaksionit të rregullt të eksportit dhe importit, është i përfshirë edhe përpunimi i jashtëm dhe i brendshëm.

Eksportet e veçanta përfshijnë eksportet e mallrave: eksportet pas përpunimit të brendshëm, eksportet për përpunim të jashtëm dhe eksportet që nuk regjistrohen në dogana.

Importet e veçanta përbëhen nga importet e mallrave nga: Importet për përpunim të brendshëm(S.S), Importet pas përpunimit të jashtëm, Importet që nuk regjistrohen në dogana.

Të përjashtuara janë mallrat që janë në transit.

Vlerësimi

Për importe, përdoret vlera cif (duke përfshirë koston, sigurimin dhe transportin e mallrave në pikën hyrëse në Kosovë). Për eksporte përdoret vlera fob (i lirë në bord). Ky është çmimi i mallrave të blerë jashtë vendit, përfshirë këtu paketimin, transportin brenda shtetit, çmimin për ngarkim, sigurimin si dhe shpenzimet tjera të cilat shfaqen kur mallrat vendosen në anije për eksportim, në aeroplan apo barten në zona të largëta. Vlera e faturës rillogaritet në vlerën e kufirit kosovar, duke shtuar apo zbritur, tërësisht apo pjesërisht, shpenzimet e transportit, ngarkimit, shkarkimit, të cilat varen nga kushtet e furnizimit të caktuara në kontratë.

Vlera përjashton:

- çdo shumë të pranuar nga eksportuesi gjatë rrugës së rifondimit, rikthimit të pagesës doganore, subversionimit apo nga ndonjë ndihme tjetër.
- çdo obligim të huaj doganor apo ndërrim të transportit të mallrave përveç në pikën doganore apo në pikën e eksportimit.

Vlera është në euro. Për transaksionet ku vlera është dhënë në një valutë tjetër, këmbimi në euro bëhet duke përdorur kursin javor të këmbimit valutor.

Periudha e referimit

Muaji kalendarik është periudhë themelore për t'i mbledhur të dhënat. Duke u bazuar në të dhënat doganore, data e dorëzimit të deklaratës doganore apo datat tjera të vlefshme për implementimin e rregullave doganore, janë koha për t'i regjistruar transaksionet e importit/eksportit.

Njësitë e sasisë

Sasia e mallrave të importuara dhe eksportuara tregohet në peshë neto, në qoftë se mund të caktohet, duke marrë parasysh natyrën e produktit si dhe në njësi plotësuese kur përshkruhet nga nomenklatura e tarifës doganore.

Pesha neto është njësi e zakonshme e sasisë së dhënë. Pesha e kontejnerëve, valixheve, qypave dhe materialeve paketues, janë të përjashtuara.

Njësitë tjera të sasisë përdoren për disa mallra më të rëndësishëm si, kafshë të gjalla, motorët e automjeteve, pajisjeve vendore, orëve, rrobave (ku si njësi matëse përdoret numri), këpucë (ku përdoret numri i palëve), mbështjellës për dysheme (ku përdoret metri katror) dhe pijet (ku përdoret vëllimi).

Shtetet partnere

Në këtë publikim, importet janë të regjistruara sipas vendit të origjinës (si e kundërta e vendit të destinimit). Mallrat e marra ose të prodhuara në një vend me prejardhje po nga i njëjti vend. Një produkt në prodhimin e të cilit janë të përfshira dy a më tepër vende, si vendi i origjinës, konsiderohet vendi në të cilin është bërë përpunimi i fundit i rëndësishëm. Paketimi, ripaketimi, klasifikimi nuk konsiderohen si procese prodhuese.

Eksportet janë të klasifikuara sipas vendit të destinimit të fundit. Destinimi i fundit i mallrave konsiderohet shteti i fundit për të cilin mallrat janë dedikuar. Kjo nuk do të thotë se është shteti ku mallrat do të shkarkohen ose ku do të bëhet konsumi i fundit.

Klasifikimi i shtetit

Nomenklatura e shteteve është klasifikimi i shteteve (gjeonomenklatura), sipas Gazetës Zyrtare të Komisionit Evropian, të publikuar çdo vit. Që nga janari 1999, përdoret sistemi ISO alfa 2 shifror i Kombeve të Bashkuara, ku secili shtet identifikohet me shifër të përbërë prej dy shkronjash.

Klasifikimi i mallrave

Statistikat mbledhen duke përdorur Nomenklaturën e Kombinuar (NK) 8 shifror – tarifave dhe nomenklaturave statistikore të BE. Kjo nomenklaturë çdo vit udhëhiqet dhe azhurnohet nga komisioni në bashkëpunim me shtetet anëtare. NK përputhet me sistemin 6 shifror të Sistemit të Harmonizuar të Përshkrimit dhe Kodimit të Mallrave (SH) – Nomenklatura e Këshillit Doganor për Bashkëpunim cila përdoret në tërë botën për aplikimin e tarifave doganore dhe përpilimin e statistikave të tregtisë së jashtme. NK përmban rreth 10,400 8- shifra nën-krerë, 6 shifrat e para të cilat janë të njëjta me shifrat e Sistemit të Harmonizuar (SH).

Klasifikimi standard i tregtisë (KST), versioni i ripunuar nr. 3 (SITC Rev 3), është zhvilluar nga Kombet e Bashkuara për krahasueshmëri të avancuar ndërkombëtare për statistika të tregtisë së jashtme.

Klasifikimi Standard i Tregtisë së Jashtme (KSTJ) versioni i ripunuar nr. 3 përmban rreth 3,100 krerë themelor (5- shifrore). Këto janë të kombinuara në 261 grupe (3-shifrore), 98 divizione (2-shifrore) dhe 10 seksione (1-shifror). Për shembull, Seksioni 6 (mallrat e fabrikua të klasifikua kryesisht sipas materialit) përbëhen nga 9 Divizione, 61 deri në 69. Divizion 64 (letër, karton dhe artikujt prej tyre) përbëhen nga dy grupe, 641 dhe 642, të cilat bashkërisht përbëjnë 72 krerë themelor, siç janë 642.94 (palloma, peshqirë, mbulesa për tavolina, dhe të ngjashme).

KSTJ versioni i ripunuar nr. 3 është identik me strukturën e Sistemit të harmonizuar. Secila kategori e KSTJ (duke përfshirë të gjithë krerët themelor) është ekuivalent me kombinimin e krerëve të SH (prandaj edhe të kombinimit të krerëve të NK).

Publikimi i të dhënave

Të dhënat mujore janë të përkohshme dhe publikohen 24 ditë pas muajit referues.

Të dhënat vjetore publikohen në qershor.

Publikimi

Të dhënat e publikuara të statistikave të tregtisë së jashtme janë:

Të dhënat e grupuara publikohen në web faqen e ASK-së, 24 ditë pas periudhës referuese.

Çdo muaj:

Statistikat mujore të tregtisë së jashtme të Kosovës.

Çdo vit:

Të dhënat përfundimtare

Statistikat e tregtisë së jashtme të Kosovës

Rrjedhat e eksportit dhe të importit per muajin Korrik 2018

Të dhënat nga Tregtia e Jashtme në Kosovë tregojnë për një deficit tregtar më të larët për (18.3%) në muajin Korrik 2018, në raport me periudhën e njëjtët të vitit 2017, gjegjësisht në vlerë prej 280,2 milion € krahasuar me deficitin 236,9 milion € në vitin 2017. Eksporti mbulon importin (9.3%).

Eksporti i mallrave në muajin Korrik 2018 kishte vlerën 28,7 milion €, ndërsa importi 309,0 milion €, është një rënie prej (25.0%) për eksport si dhe rritje prej (12.2%) për import duke krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2017.

Sipas të dhënave të grupeve kryesor të eksportit: (31.3%) të eksporteve e përbëjnë metalet bazë dhe artikujt prej tyre, (13.7%) ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani, (13.5%) plastikë, gomë dhe artikuj prej tyre, (12.5%) produktet minerale, (8.5%) produktet bimore, (3.1%) tekstil dhe artikuj tekstili, (2.9%) makineritë, pajisjet mekanike dhe elektrike, (2.8%) lëkurë dhe artikuj prej tyre etj.

Ndërsa sipas të dhënave të grupeve kryesor për import: të importit e përbëjnë (14.4%) produktet minerale, (14.1%) makineritë, pajisjet mekanike dhe elektrike, (12.6%) ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani, (11.0%) metalet bazë dhe artikujt prej tyre, (7.4%) mjetet e transportit, (6.8%) produkte të industrisë kimike, (6.3%) plastikë, gomë dhe artikuj prej tyre, (4.3%) tekstil dhe artikuj tekstili etj.

Tregtia e jashtme e mallrave me vendet e BE-së-28

Eksportet e Kosovës në vendet e BE-së-28 arritën në 7,6 milion €, ose rreth (26.7%) e eksporteve të përgjithshme, me një rënie prej (9.9%). Partneret kryesor për eksportin e mallrave në BE janë: Gjermania (6.2%), Sllovenia (4.8%), Holanda (4.6%).

Importet e Kosovës nga vendet e BE-së-28 ishin rreth 126,6 milion €, ose (41.0%) e importeve të përgjithshme, një rritje prej (6,7%). Importet me pjesmarje me të lartë ishin nga: Gjermania (11.6%), Italia (7.2%), Greqia (2.9%), Polonia (2.6), Romania (2.3%) etj.

Tregtia me vendet e CEFTA-së.

Në muajin Korrik 2018, eksportet e Kosovës me vendet CEFTA-së arritën në 16,0 milion €, ose (55.7%) të eksporteve të përgjithshme, me një rënie prej (24.2%). Partner kryesor për eksport nga vendet e CEFTA-së janë: Shqipëria (23.7%), Maqedonia (12.7%), Serbia (11.1%), Mali i zi (5.5%).

Ndërsa, importet nga vendet e CEFTA-së në muajin Korrik 2018, arritën në 82,3 milion €, ose (26.7) të importeve të përgjithshme, me një rritje prej (7.4%). Vendet me pjesmarje më të lartë për import ishin: Serbia (12.1%), Shqipëria (7.0%), Maqedonia (4.9%) dhe B&H (2.1%).

Tregtia me vendet e tjera të botës

Eksportet e Kosovës me vendet tjera arritën në 5,0 milion €, ose (17.6%). Si partner më të rëndësishëm nga këto vendet për eksport vlen të përmendën: Zvicra (8.4%) dhe India (3.3%)

Ndërsa importet e Kosovës me vendet tjera arritën në 100,0 milion €, ose (32.4%). Vendet me pjesmarje më të lartë për import në këtë grup ishin: Kina (10.5%) dhe Turqia (9.9%).

Tabela 1: Qarkullimi i mallrave në tregtinë e jashtme

(000€)

Periudha	Eksportet (FOB)	Importet (CIF)	Bilanci tregtar	Përqindja e mbulimit
1	2	3	4=2-3	5=2/3
2001	10,559	684,500	-673,941	1.5
2002	27,599	854,758	-827,159	3.2
2003	35,621	973,265	-937,644	3.7
2004	56,567	1,063,347	-1,006,780	5.3
2005	56,283	1,157,492	-1,101,209	4.9
2006	110,774	1,305,879	-1,195,105	8.5
2007	165,112	1,576,186	-1,411,074	10.5
2008	198,463	1,928,236	-1,729,773	10.3
2009*	165,328	1,937,539	-1,772,211	8.5
2010	295,957	2,157,725	-1,861,769	13.7
2011	319,165	2,492,348	-2,173,184	12.8
2012	276,100	2,507,609	-2,231,509	11.0
2013	293,842	2,449,064	-2,155,221	12.0
2014	324,543	2,538,337	-2,213,794	12.8
2015	325,294	2,634,693	-2,309,399	12.3
2016	309,627	2,789,491	-2,479,864	11.1
2017	378,010	3,047,018	-2,669,007	12.4
01-2016	22,276	132,626	-110,351	16.8
02-2016	24,082	193,676	-169,593	12.4
03-2016	25,583	235,520	-209,937	10.9
04-2016	23,027	250,672	-227,645	9.2
05-2016	27,098	238,040	-210,941	11.4
06-2016	30,339	247,222	-216,883	12.3
07-2016	30,397	240,934	-210,537	12.6
08-2016	21,462	270,468	-249,006	7.9
09-2016	21,670	232,676	-211,006	9.3
10-2016	27,066	241,325	-214,259	11.2
11-2016	32,107	234,859	-202,752	13.7
12-2016	24,520	271,473	-246,954	9.0
01-2017	21,447	146,761	-125,313	14.6
02-2017	23,696	197,904	-174,208	12.0
03-2017	31,261	264,723	-233,462	11.8
04-2017	31,219	251,921	-220,703	12.4
05-2017	33,492	279,205	-245,713	12.0
06-2017	38,199	255,694	-217,495	14.9
07-2017	38,367	275,353	-236,986	13.9
08-2017	32,592	297,251	-264,659	11.0
09-2017	34,110	248,098	-213,988	13.7
10-2017	34,055	272,127	-238,072	12.5
11-2017	30,091	260,674	-230,584	11.5
12-2017	29,481	297,305	-267,824	9.9
01-2018	24,522	195,066	-170,543	12.6
02-2018	22,397	205,240	-182,843	10.9
03-2018	26,441	255,414	-228,974	10.4
04-2018	25,535	270,321	-244,786	9.4
05-2018	32,807	310,625	-277,818	10.6
06-2018	37,130	305,728	-268,598	12.1
07-2018	28,776	309,061	-280,285	9.3

2018) janë te dhëna preliminare

2009) Te dhenat për import ndryshojnë nga publikimet e me hershme

Tabela 2: Qarkullimi i mallrave në tregtinë e jashtme, kumulativ

(000€)

Periudha	Eksportet (FOB)	Importet (CIF)	Bilanci tregtar	Përqindja e mbulimit
1	2	3	4=2-3	5=2/3
01-2016	22,276	132,626	-110,351	16.8
02-2016	46,358	326,302	-279,944	14.2
03-2016	71,941	561,823	-489,881	12.8
04-2016	94,968	812,495	-717,527	11.7
05-2016	122,066	1,050,534	-928,468	11.6
06-2016	152,405	1,297,756	-1,145,351	11.7
07-2016	182,802	1,538,691	-1,355,888	11.9
08-2016	204,264	1,809,158	-1,604,894	11.3
09-2016	225,934	2,041,834	-1,815,900	11.1
10-2016	253,000	2,283,159	-2,030,159	11.1
11-2016	285,108	2,518,018	-2,232,910	11.3
12-2016	309,627	2,789,491	-2,479,864	11.1
01-2017	21,447	146,761	-125,313	14.6
02-2017	45,143	344,665	-299,522	13.1
03-2017	76,404	609,388	-532,984	12.5
04-2017	107,623	861,309	-753,687	12.5
05-2017	141,115	1,140,514	-999,399	12.4
06-2017	179,314	1,396,208	-1,216,894	12.8
07-2017	217,681	1,671,562	-1,453,880	13.0
08-2017	250,274	1,968,813	-1,718,539	12.7
09-2017	284,384	2,216,911	-1,932,527	12.8
10-2017	318,439	2,489,038	-2,170,599	12.8
11-2017	348,529	2,749,712	-2,401,183	12.7
12-2017	378,010	3,047,018	-2,669,007	12.4
01-2018	24,522	195,066	-170,543	12.6
02-2018	46,919	400,306	-353,387	11.7
03-2018	73,360	655,720	-582,360	11.2
04-2018	98,894	926,041	-827,146	10.7
05-2018	131,702	1,236,666	-1,104,964	10.6
06-2018	168,832	1,542,394	-1,373,562	10.9
07-2018	197,608	1,851,455	-1,653,847	10.7

Tabela 3: Eksportet dhe importet sipas procedurave statistikore

Procedurat statistikore	(000€)				
	Korr- 2017		Korr -2018		Indices 2018/ 2017
	Value	%	Value	%	
Gjithsejt Eksportet	38,367	100.0	28,776	100.0	75
1 Eksportet normale	31,783	82.8	25,203	87.6	79.3
2 Eksportet pas përpunimit të brendshëm	6,584	17.2	3,574	12.4	54.3
3 Eksportet për përpunim të jashtëm	:	:	:	:	:
9 Eksportet që nuk regjistrohen ne dogana	:	:	:	:	:
Gjithsejt Importet	275,353	100.0	309,061	100.0	112
1 Importet normale	270,005	98.1	306,672	99.2	113.6
2 Importet për përpunim të brendshëm(S.S)	5,349	1.9	2,389	0.8	44.7
3 Importet pas përpunimit të jashtëm	:	:	:	:	:
9 Importet që nuk regjistrohen ne dogana	:	:	:	:	:

Tabela 4: Eksportet dhe importet sipas seksioneve të KSTJ (SITC)

Seksionet sipas KSTJ	(000€)			
	Korr -2017		Korr -2018	
	Vlera	%	Vlera	%
Eksportet (FOB)				
Gjithsej	38,367	100.0	28,776	100.0
Ushqime dhe kafshë të gjalla	3,052	8.0	2,905	10.1
Pije dhe duhan	2,488	6.5	3,188	11.1
Materiale të papërpunuara	9,498	24.8	5,857	20.4
Lëndë djegëse	7,830	20.4	2,114	7.3
Yndyrna bimore dhe shtazore	:	:	42	0.1
Produkte kimike	1,693	4.4	1,730	6.0
Mallra të përpunuara	10,048	26.2	8,052	28.0
Makineri e pajisje transporti	687	1.8	1,166	4.1
Mallra të tjera të përpunuara	3,065	8.0	3,720	12.9
Mallra të pa klasifikuara diku tjetër	6	0.0	3	0.0
Importet (CIF)				
Gjithsej	275,353	100.0	309,061	100.0
Ushqime dhe kafshë të gjalla	41,953	15.2	44,683	14.5
Pije dhe duhan	15,694	5.7	17,175	5.6
Materiale të papërpunuara	6,686	2.4	4,328	1.4
Lëndë djegëse	31,063	11.3	39,550	12.8
Yndyrna bimore dhe shtazore	2,122	0.8	2,069	0.7
Produkte kimike	31,070	11.3	33,388	10.8
Mallra të përpunuara	61,513	22.3	69,328	22.4
Makineri e pajisje transporti	56,459	20.5	66,350	21.5
Mallra të tjera të përpunuara	28,584	10.4	31,977	10.3
Mallra të pa klasifikuara diku tjetër	211	0.1	212	0.1

Tabela 5: Eksportet dhe importet sipas seksioneve në vlerë dhe në përqindje

(000€)

Kodi	Seksionet sipas Sistemit të Harmonizuar(HS)	Korr - 2017		Korr - 2018	
		Vlera	%	Vlera	%
Eksportet (FOB)					
	Gjithsejt	38,367	100.0	28,776	100.0
1	Kafshë të gjalla, produkte me origjinë kafshe	66	0.2	81	0.3
2	Produkte bimore	2,536	6.6	2,458	8.5
3	Yndyrëra	:	:	42	0.1
4	Ushqime të përg. pije dhe duhan	3,316	8.6	3,930	13.7
5	Produkte minerale	11,877	31.0	3,594	12.5
6	Produkte të industrisë kimike	449	1.2	463	1.6
7	Plastikë,gomë dhe artikuj prej tyre	3,607	9.4	3,887	13.5
8	Lëkurë dhe artikuj prej tyre	1,184	3.1	797	2.8
9	Druri dhe artikuj druri	283	0.7	398	1.4
10	Letër dhe artikuj prej letëre	448	1.2	461	1.6
11	Tekstil dhe artikuj tekstili	867	2.3	893	3.1
12	Veshëmbathje të këmbëve	80	0.2	62	0.2
13	Art.prej guri, allçie, prod. qeramike dhe qelqi	495	1.3	651	2.3
14	Perla, gurë të çmuar, metale të çmuara etj.	0	0.0	55	0.2
15	Metale bazë dhe artikuj prej tyre	11,687	30.5	9,003	31.3
16	Makineri, paisje mekanike dhe elektrike	647	1.7	838	2.9
17	Mjetet e transportit	123	0.3	392	1.4
18	Instr.optike,mjeksore,fotog.,muzikore etj.	11	0.0	56	0.2
19	Armët dhe municionet	:	:	:	:
20	Artikuj të ndryshëm të prodhura	684	1.8	708	2.5
21	Veprat e artit	6	0.0	5	0.0
Importet(CIF)					
	Gjithsejt	275,353	100.0	309,061	100.0
1	Kafshë të gjalla, produkte me origjinë kafshe	10,772	3.9	12,280	4.0
2	Produkte bimore	9,235	3.4	11,540	3.7
3	Yndyrëra	2,367	0.9	2,289	0.7
4	Ushqime të përg. pije dhe duhan	37,924	13.8	38,813	12.6
5	Produkte minerale	37,204	13.5	44,619	14.4
6	Produkte të industrisë kimike	19,506	7.1	21,088	6.8
7	Plastikë,gomë dhe artikuj prej tyre	17,804	6.5	19,325	6.3
8	Lëkurë dhe artikuj prej tyre	1,220	0.4	1,149	0.4
9	Druri dhe artikuj druri	7,865	2.9	8,013	2.6
10	Letër dhe artikuj prej letëre	3,858	1.4	4,805	1.6
11	Tekstil dhe artikuj tekstili	12,686	4.6	13,287	4.3
12	Veshëmbathje të këmbëve	2,424	0.9	2,728	0.9
13	Art.prej guri, allçie, prod. qeramike dhe qelqi	12,142	4.4	12,343	4.0
14	Perla, gurë të çmuar, metale të çmuara etj.	270	0.1	440	0.1
15	Metale bazë dhe artikuj prej tyre	29,854	10.8	34,123	11.0
16	Makineri, paisje mekanike dhe elektrike	35,209	12.8	43,487	14.1
17	Mjetet e transportit	20,719	7.5	22,858	7.4
18	Instr.optike,mjeksore,fotog.,muzikore etj.	4,498	1.6	3,438	1.1
19	Armët dhe municionet	53	0.0	70	0.0
20	Artikuj të ndryshëm të prodhura	9,524	3.5	12,149	3.9
21	Veprat e artit	218	0.1	218	0.1

Tabela 6: Eksportet sipas vendeve në vlerë dhe në përqindje

(000€)

Vendet	Korr - 2017		Korr - 2018	
	Vlera	%	Vlera	%
Eksportet (FOB)				
Gjithsej	38,367	100.0	28,776	100.0
28 vendet e BE_së	8,516	22.2	7,670	26.7
Austria	599	1.6	394	1.4
Belgjika	55	0.1	106	0.4
Britania e Madhe	762	2.0	414	1.4
Danimarka	1,267	3.3	0	0.0
Franca	367	1.0	312	1.1
Gjermania	1,021	2.7	1,792	6.2
Greqia	91	0.2	60	0.2
Holanda	1,154	3.0	1,320	4.6
Hungaria	87	0.2	55	0.2
Irlanda	:	:	4	0.0
Italia	825	2.2	419	1.5
Luksemburg	11	0.0	20	0.1
Polonia	725	1.9	470	1.6
Republika Çeke	36	0.1	0	0.0
Slovakia	11	0.0	15	0.1
Slovenia	207	0.5	1,379	4.8
Spanja	49	0.1	69	0.2
Suedia	115	0.3	54	0.2
Rumani	159	0.4	117	0.4
Bullgaria	835	2.2	446	1.5
Kroacia	118	0.3	212	0.7
Të tjera të BE_së	21	0.1	14	0.0
Cefta	21,152	55.1	16,034	55.7
Shqipëria	4,912	12.8	6,832	23.7
Maqedonia	4,403	11.5	3,667	12.7
Mali i Zi	2,421	6.3	1,570	5.5
Serbia	8,265	21.5	3,186	11.1
Bosnja dhe Hercegovina	1,150	3.0	778	2.7
Moldavia	1	0.0	1	0.0
EFTA	1,596	4.2	2,525	8.8
Zvicra	1,596	4.2	2,426	8.4
Icelanda	:	:	:	:
Norvegjija	:	:	99	0.3
Liechtensten	:	:	:	:
Vendet tjera evropiane	1,049	2.7	778	2.7
Turqia	1,021	2.7	777	2.7
Ukraina	28	0.1	2	0.0
Vendet tjera jo evropiane	224	0.6	186	0.6
SHBA	222	0.6	184	0.6
Canada	2	0.0	1	0.0
Brazili	:	:	:	:
Mexico	:	:	1	0.0
Vendet nga Azija	5,617	14.6	1,039	3.6
Japonia	23	0.1	8	0.0
Kina	122	0.3	83	0.3
India	5,472	14.3	948	3.3
Të tjera	214	0.6	542	1.9

Tabela 7: Importet sipas vendeve në vlerë dhe në përqindje

Vendet	Korr - 2017		Korr - 2018	
	Vlera	%	Vlera	%
Importet (CIF)				
Gjithsej	275,353	100.0	309,061	100.0
28 vendet e BE_së	118,663	43.1	126,624	41.0
Austria	4,153	1.5	5,790	1.9
Belgjika	864	0.3	936	0.3
Britania e Madhe	2,431	0.9	2,212	0.7
Danimarka	364	0.1	787	0.3
Franca	2,582	0.9	3,444	1.1
Gjermania	34,003	12.3	35,712	11.6
Greqia	14,284	5.2	8,969	2.9
Holanda	1,927	0.7	2,313	0.7
Hungaria	1,831	0.7	2,916	0.9
Irlanda	208	0.1	140	0.0
Italia	19,396	7.0	22,138	7.2
Luksemburg	62	0.0	71	0.0
Polonia	7,150	2.6	8,081	2.6
Republika Çeke	1,789	0.6	2,389	0.8
Slovakia	918	0.3	1,088	0.4
Slovenia	6,184	2.2	6,900	2.2
Spanja	5,294	1.9	4,506	1.5
Suedia	641	0.2	826	0.3
Rumani	2,785	1.0	6,995	2.3
Bullgaria	5,180	1.9	4,924	1.6
Kroacia	5,689	2.1	4,414	1.4
Të tjera të BE_së	926	0.3	1,074	0.3
Cefta	76,714	27.9	82,382	26.7
Shqipëria	13,608	4.9	21,483	7.0
Maqedonia	13,910	5.1	15,295	4.9
Mali i Zi	1,949	0.7	1,624	0.5
Serbia	38,923	14.1	37,427	12.1
Bosnja dhe Hercegovina	8,324	3.0	6,472	2.1
Moldavia	:	:	81	0.0
EFTA	2,325	0.8	4,355	1.4
Zvicra	2,210	0.8	4,312	1.4
Icelanda	1	0.0	:	:
Norvegjija	96	0.0	37	0.0
Liechtensten	19	0.0	6	0.0
Vendet tjera evropiane	28,730	10.4	32,347	10.5
Turqia	27,933	10.1	30,446	9.9
Ukraina	796	0.3	1,902	0.6
Vendet tjera jo evropiane	7,121	2.6	7,767	2.5
SHBA	2,404	0.9	2,945	1.0
Canada	255	0.1	107	0.0
Brazili	3,991	1.4	4,473	1.4
Mexico	471	0.2	243	0.1
Vendet nga Azija	30,608	11.1	35,344	11.4
Japonia	1,753	0.6	1,096	0.4
Kina	27,121	9.8	32,402	10.5
India	1,735	0.6	1,846	0.6
Të tjera	11,192	4.1	20,242	6.5

Agjencia e statistikave të Kosovës

përshkrim i shkurtër

Agjencia e statistikave të Kosovës është institucion profesional i cili merret me grumbullimin, përpunimin dhe publikimin e të dhënave zyrtare të statistikave. Si i tillë vepron që nga viti 1948 i cili ka kaluar nëpër disa faza historike, i strukturuar sipas rregullimit shtetëror të asaj kohe.

Më 2 Gusht 1999, Agjencioni ka rifilluar punën e vet profesionale (pas 9 viteve të ndërprerjes të të gjitha serive statistikore në dëm të interesit të Kosovës), si institucion i pavarur në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike. Që nga data 12.12.2011 ky Agjencion vepron në kuadër të Kryeministrisë së Kosovës. Agjencioni financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës por edhe nga donatorët për projekte të veçanta dhe për ndihmë teknike profesionale.

Agjencia e Statistikave të Kosovës vepron sipas Ligjit Nr. 04/L-036 i cili ka hyrë në fuqi me 12.12.2011. Programi i Statistikave Zyrtare, 2013/2017 është në implementim për zhvillimin e sistemit statistikor në korrelacion me Statistikat e Bashkësisë Evropiane (EUROSTAT-it).

Agjencia e statistikave të Kosovës ka këtë strukturë organizative: *Departamentet prodhuese;* (Departamenti i statistikave ekonomike dhe llogarive kombëtare, Departamenti i statistikave të bujqësisë dhe mjedisit, dhe Departamenti i statistikave sociale. *Departamentet mbështetëse;* (Departamenti i metodologjisë dhe teknologjisë informative, Departamenti për politika, planifikim, koordinim dhe komunikim, Departamentii i Regjistrimit dhe Anketimit si dhe Departamenti i administratës. *Ne kuadër të Agjencionit veprojnë edhe; Zyrrat Rajonale;* Gjakovë, Gjiilan, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Prishtinë, dhe Ferizaj

Numri i të punësuarve dhe buxheti akoma janë të limituar. Të punësuar janë gjithsej 143 punëtorë, prej tyre, 98 (68,5%) në seli të Agjencionit, gjersa në Zyrrat Rajonale, 45 (31,5%), Agjencioni ka këtë strukturë kualifikuese, 61,7% me shkollim universitar, 15,4 me shkollim të lartë, ndërsa 17,5% me shkollim të mesëm.

Kemi bashkëpunim profesional dhe teknik me të gjitha Ministrinë e Qeverisë së Kosovës, sidomos me Ministrin e Ekonomisë dhe Financave, Bankën Qendrore të Kosovës, me institucionet ndërkombëtare, EUROSTAT-in, Fondin Monetar Ndërkombëtare, Bankën Botërore, SIDA e Suedisë, DFID, UNFPA, UNDP, UNICEF, dhe me statistikatat e shteteve në rajon.

Agjencia e Statistikave të Kosovës mbulon gati krejtësisht territorin e Republikës së Kosovës, duke u organizuar në strukturimin e qarqeve statistikore dhe njësisve raportuese si njësi bazë dhe të vetme në shkallë vendi nga të cilat merr informatat e dorës së parë. Te gjitha anketat e zhvilluara në terren përdorin shtrirjen e mostrës në këto qarqe statistikore por edhe metodologjinë sipas rekomandimeve ndërkombëtare. Gjatë grumbullimit të të dhënave statistikore dhe raporteve nga njësitë raportuese angazhohen; profesionistë, teknikë, administratorë, civilë të zyrave të vendit, regjistruar terreni nga Zyrrat Rajonale etj.

Në vitin 2011 është realizuar me sukses projekti i Regjistrimit të Popullsisë Ekonomike Familjar dhe Banesave, ndërsa në vitin 2014 është realizuar po ashtu me sukses Rregjistrimi i Bujqësisë . Rezultatet e fituara nga këto regjistrime do të kenë një rol të rëndësishëm për hartimin e Politikave zhvillimore.

Misioni i Agjencionit; të përmbush nevojat e shfrytëzuesve me të dhëna statistikore kualitative, objektive, në kohë dhe hapësirë në mënyrë që shfrytëzuesit të kenë bazë të besueshme që të bëjnë analiza të rregullta në interes të planifikimit dhe zhvillimit gjatë hartimit të projekteve në shkallë vendbanimi, komune dhe vendi. Të përkrah institucionet qeveritare, institutet, shkencën, akademinë , bizneset si dhe hulumtuesit e pavarur etj. në mënyrë që t'u sigurojë informata të duhura për vendim-marrësit si dhe përdoruesit tjerë në Kosovë.

- **Adresa: AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS,**
Rr. "Zenel Salihu", nr. 4, 10000 Prishtinë
- **Telefoni:** +383 (0) 38 200 31 129
Kryeshefi Ekzekutiv: +383 (0) 38 200 31 112
- **Fax::** +383 (0) 38 235 033
- **E-mail:** infoask@rks-gov.net
- **Ueb-faqe:** <http://ask.rks-gov.net>